



Republika e Kosovës



Komuna Vushtri

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

07Nr.08/2011

Vushtri, më 21.01.2011

Në bazë nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shpall:

K O N K U R S

Për vendet e punës:

- **Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-Vushtri**
- **I.Vendi i Punës:Doktor të mjekësisë**

Numri i ekzekutuesve(pozitave) pesë(5).

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

- Ofrojnë shërbime shëndetësore në kuadër të kujdesit primar shëndetësor pranë QKMF,QMF DHE ASH;
- Ofrojnë diagnostifikimin dhe menaxhimin efektiv të pacientëve duke siguruar edhe referimin në institucionet gjegjëse shëndetësore.);
- Të kenë vetiniciativë dhe ti përmbahen etikës mjekësore dhe kodit të mirësjelljes ;
- Të mbikëqyrin dhe menaxhojnë punën e infermierëve dhe të stafit tjetër përcjellës në QKMF,QMF dhe ASH.;
- Kryejnë të gjitha punët e mjekut nga lëmi i mjekësisë familjare;
- Për punën e vetë i përgjigjen shefit të mjekësisë familjare;
- Të jenë të gatshëm të punojnë në grupe në situata të jashtëzakonshme;
- Të kenë vetiniciativë dhe të i përmbahen etikës mjekësore;

Kualifikimi profesional, aftësitë .

-Të ketë të kryer Fakultetin e Mjekësisë-Drejtimi i përgjithshëm

-Të kenë të kryer stazhin e obliguar sipas ligjit dhe të jenë të licencuar.

Periudha e kontratës:

Tre muaj punë provuese me mundësi vazhdimi deri në 2 vjet.

Paga:Koefficienti 7.20

Orët e punës :40

II.Vendi i punës:Nëpunës i të dhënave të shërbimit informativ shëndetësor

Numri i ekzekutuesve një(1)

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

- Përpunon të dhënat e fletëzave kompjuterike në bazën e SISH;
- Përpilon raporte dhe pasqyra periodike lidhur me të dhënat e SISH;
- Bënë arkivimin e bazës së të dhënave të SISH;
- Kryen edhe punë të tjera me kërkesë të përgjegjësit në pajtim me ligjin.

Kushtet:-Të ketë të mbaruar shkollën e mesme të –technik i informatikës;
-Përvojë në punën lidhur me përpunimin e të dhënave në data base
-Njohja e punës në kompjuter
-Preferohet edhe njohje e gjuhës angleze;

Periudha e kontratës:3 muaj punë provuese me mundësi vazhdimi deri në 2 vjet;

Orët e punës :40 orë në javë.

Koeficienti 5.4

-Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkangjesin: **Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit të dhe certifikatën e lindjes, certifikatën mbi njohjen e punës në kompjuter,të jenë banor të Republikës së Kosovës,mos të kenë fletëparaqitje penale dhe të dënuar , certifikatën shëndetësore.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Sektorin për menaxhimin e personelit (zyra numër 8),nr. i tel. 028-572-416.

Mirëpritet aplikimi prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve të Republikës Kosovës.

Drejtori i DSHMQS
Safet Idrizi